**AKT THEMELIMI**
**I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**
**"OS Metal" SH.P.K.**

Sot më datë 10.03.2021:

- Sadik PISHA, shtetas shqipëtar lindur më 14.56.1977, në Elbasan dhe banues në Elbasan, pajisur me letërnjoftim me numer personal H70514004Q;

I cili me nënshkrimin e këtij Akti Themelimi dhe në përputhje me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*" i ndryshuar dhe legjislacioni në fuqi të Republikës së Shqipërisë është dakort të themelojnë një shoqëri me përgjegjesi të kufizuar e cila do të ushtrojë aktivitetin në përputhje me legjislacionin Shqiptar, Aktin e themelimit dhe dispozitat e Statutit bashkëlidhur, si pjesë integrale të këtij Akti Themelimi.

**Neni 1 - Emërtimi dhe forma e shoqërisë**

1.1 Shoqeria emertohet **"OS Metal" Sh.p.k.** dhe themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (ne vijim "Shoqëria").

1.2 Shoqëria themelohet në bazë të legjislacionit shqiptar dhe do të ushtrojë aktivitetin në përputhje me legjislacionin Shqiptar, Aktin e Themelimit dhe dispozitat e Statutit.

1.3 Shoqëria ka vulën dhe logon e saj zyrtare.

**Neni 2 - Selia**

2.1 Selia e Shoqëriseështe në adresë:

- ***Elbasan, Bradashesh, Metalurgji, rruga Elbasan-Metalurgji, zk.3965, pasuria nr.986.***

2.2 Shoqëria mund të ketë zyra, degë, zyra përfaqësimi dhe agjenci si në adresa të tjera në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj.

2.3 Asambleja e Përgjithshme mund të çelë, transferojë dhe /apo mbyllë, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, degë dhe/ose zyra përfaqësimi. Ndërsa, Administratori i Shoqërisë mund të çelë, transferojë dhe /apo mbyllë, si ne Shqipëri ashtu edhe jashtë saj , seli sekondare, filiale dhe /ose agjenci.

**Neni 3 – Objekti**

Grumbullim, magazinim dhe perpunim per eksport alumin, baker, antimon, kanoçe, bronx dhe metale te tjera me ngjyre. Transportim i mbetjeve te rrezikshme. Eksport te mbetjeve te rrezikshme dhe jo te rrezikshme si: Mbetjet e Bakrit; Bronzit; Tunxhit; Aluminit; Inoksit;

Plumbit; Zinkut; Mbetje Bateri Makinash dhe Mbetje metalesh te tjera me ngjyre joferrore. Importin e mbetjeve te Bakrit; Bronzit; Aluminit; Inoksit; Zink etj.

**Neni 4 - Kohëzgjatja e Shoqërisë**

4.1 Shoqëria themelohet dhe e ushtron veprimtarinë e saj për një kohëzgjatje të pakufizuar.

4.2 Shoqëria mund të prishet në çdo moment me vendim te Asamblesë së Përgjithshme.

**Neni 5 - Kapitali dhe Kuotat**

5.1 Kapitali i Shoqërise është i barabartë me 100 (njëqind) lekë, i ndarë në 1 (një) kuotë

5.2 Kapitali është nënshkruar dhe shlyer tërësisht si më poshtë vijon:

- Sadik Pisha, i cili ka shlyer kontributin në Shoqëri, në para në shumën e barabartë me 100 (njëqind) lekë; dhe

5.3 Bazuar në kontributet e cituara më sipër:

- Sadik Pisha, ka 1 (një) kuotë, të barabartë me 100% (njëqind për qind) të kapitalit të Shoqërisë.

**Neni 6 - Administrimi**

7.1 Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj, i cili është dhe përfaqësuesi ligjor i saj.

Administratori është përfaqësuesi i Shoqërise në marrëdhënie me të tretët dhe ka kompetenca të plota në drejtimin e saj, me përjashtim të kompetencave të cilat i ka asambleja e ortakëve, sipas përcaktimeve në statut.

7.2 Administratori mund të emëroj/në përfaqësues me prokurë speciale ("*ad negotia*") për kryerjen e një akti ose kategori aktesh në kufijtë e tagrave që u janë dhëne atyre nga ligji në fuqi ose Statuti.

7.3 Si Administrator i pare është emeruar personi me të dhënat e mëposhtme:

Z. Sadik Pisha, shtetas shqipëtar lindur më 14.05.1977, në Elbasan dhe banues në Elbasan, pajisur me letërnjoftim me numer personal H70514004Q.

Ai do të ushtrojë funksionet e tij për një afat 5 (pese) vjeçar i rinovueshëm

## Neni 7 - Dispozita të Fundit

7.1 Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin Shqipetar ne fuqi dhe vecanerisht te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Shoqerirë Tregtare" , si dhe duke zbatuar ligjet nderkombetare dhe te vendit si dhe rregullave qe zbatohen per biznesin qe kryen kjo shoqeri .

7.2 Për çdo çështje që nuk rregullohet posaçërisht nga ky Akt Themelimi, do të zbatohen dispozitat përkatese të legjislacionit shqiptar.

7.3 Akti i themelimit u perpilua ne tre kopje: dy kopje, per t'ju shperndare organeve kompetente dhe nje kopje do te mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise.

Akti i themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortaku themelues.

**ORTAKU THEMELUES**

Sadik PISHA

Sadik Pisha